



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA**

VENDIM

Nr. 21, datë 30.03.2018

PËR

**TARIFAT E DHËNIES SË INFORMACIONIT (DOKUMENTACIONIT) TË
KËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Tarifat e shërbimit të dhënies së informacionit (fotokopje ose CD) të jenë si më poshtë:

- a) Deri në 10 fletë informacioni përfitohet pa pagesë;
- b) Mbi 10 fletë për formatin A4 pagesa do të jetë 5 (pesë) lekë/fletë;
- c) Për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë 60 (gjashtëdhjetë) lekë/CD.

2. Specialisti përkatës i sektorit i cili do të përgatisë informacionin e kërkuar, në bashkëpunim me koordinatorin për të drejtën e informimit të institucionit, duhet të përlllogarisë koston reale të informacionit të kërkuar, duke ia vënë në dispozicion edhe kërkuesit/subjektit të interesuar.

3. Me pagesën e tarifës përkatëse nga kërkuesi /subjekti i interesuar, menjëherë dërgohet informacioni i kërkuar tek kërkuesi /subjekti i interesuar.

4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinatorin për të Drejtën e Informimit, pranë Entit Rregullator të Ujit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ndriçim Shani